

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit M. M., nga P. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragraf 1 te KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.317/2016 të datës 13.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarit, dhe të dëmtuarës Z. M., me datë 18.01.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. M., nga i ati M. dhe nëna M. e lindur Q., i lindur me datë *data e lindjes...* në P., ku edhe tani jeton, rruga ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme, kuzhinier, i martuar, baba i një fëmiut, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 23.01.2015, rreth orës 23,30 minuta, në Prizren, në fshatin L., duke shkel Ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtareve, të markës “Fiat Punto”, ngjyrë e kafet, me targa *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet dhe del jashtë rrugës kryesore në kthesë në anën e djathtë, si pasoj vjen deri te goditja në kanal in anësor që ndodhej përkaj rrugës, me ç’ rast përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkë udhëtarja e tij – e dëmtuara Z. M., lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko ligjor, dr. N. H., të dhënë me datë 02.05.2016,

Këso dore ka kryer veprën penale të rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragraf 1 te KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 Euro, si dhe në emër të ekspertizës të komunikacionit shumë prej 40,88 Euro, dhe në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.317/2016 të datës 13.06.2016, kundër të akuzuarit M. M., nga P., për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-ës,

Prokurori i shtetit Sahide Sefa, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.317/2016 të datës 13.06.2016, kundër të akuzuarit M. M., nga P., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së , dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysht të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysht pranimit të fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

E dëmtuara Z. M., nga babai L. dhe nëna H. e lindur H., e lindur me datën *data e lindjes...* në D., tani jeton në N., deklaroi që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësore juridike, pasi që të akuzuarin e ka bashkëshort.

I akuzuari M. M., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, duke theksuar që me datën 23.01.2015, rreth orës 23,30 minuta, ka qarkulluar në relacionin L. – P., dhe me të arritur në fshatin e cekur, duke drejtuar automjetin e markës “Fiat Punto” me targa të regjistrimit *numri i targës..* nga pakujdesia e ka goditur kanalin anësor që gjendej përkaj rrugës. Andaj të cekurat më lart, i propozoj gjykatës ti merr si rrethanë lehtësuese, e po ashtu edhe faktin që deri te aksidenti ka ardhur pa vullnetin dhe dëshirën time, nuk ka ekzistuar qëllimi për kryerjen e kësaj vepre, jam person familjar, baba i një fëmiut, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla. Të gjitha këto rrethanat konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 23.01.2015, rreth orës 23,30 minuta, në Prizren, në fshatin L., i akuzuari duke shkel Ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtareve, të markës “Fiat Punto”, ngjyrë e kafet, me targa *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet dhe del jashtë rrugës kryesore në kthesë në anën e djathtë, si pasoj vjen deri te goditja në kanal in anësor që ndodhej përkaj rrugës, me ç’ rast përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkë udhëtarja e tij – e dëmtuara Z. M., lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko ligjor, dr. N. H., të dhënë me datë 02.05.2016,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, është person familjar, raportet familjare të akuzuarit me palën e dëmtuar, dhe ate raportet motër vëlla, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i një fëmiu, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1265/2016 me datë 18.01.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.